



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ADRIANA J. SOLIS
ADRESA BLV"GJERGJ FISHTA",
NR.88
TEL: 694066803

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 549

Nr. koleksioni: 155

Tirane më 04/12/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

***Akti noterial përbëhet nga 3 fletë**



A2024051090017729299



KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(Te Shoqërise "LumosTech-Solutions" sh.p.k)

Sot, më datë 17/12/2024 (Dymije e njezet e kater), para meje Notere ADRIANA J. SOLIS, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, BLV "GJERGJ FISHTA", NR.88, u paraqit personalisht:

SHITES:

Endrit Zhapa, atësia Besnik, amësia Manjola, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Themistokli Gërmenji; Nd. 8; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1010; Tiranë, lindur më 04/03/1999, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038031258 dhe nr. personal J90304043H, (ne cilesine e Shitesit)

BLERES:

Erold Balla, atësia Ferit, amësia Zhaneta, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë V.Huta P4 Sh1 Ap15; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 22/03/1978, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035558495 dhe nr. personal H80322059L, (ne cilesine e Bleresit)

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "LumosTech-Solutions" shpk, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Dispozita Te Pergjithshme

- 1.1 Shoqëria "LumosTech-Solutions" shpk, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar si person juridik pranë Qendres Kombëtare të Biznesit, datë 25/10/2024 me NIPT: M42225047F, me adresë: Tirane, Autostrada Tirane-Durres km1, Mezes, Tirane, Zyrat Rr.Pjeter Bogdani, H.nr.5, Ap.2, K.1, pallat 10 katesh Tirane
- 1.2 Shoqëria është krijuar me ortakëri nga Endrit Zhapa dhe Erold Balla, me nga 1 (një) kuote kapitali secili, me vlerë 50,000(pesdhjete mijë) leke secila.
- 1.3 Objekti i kësaj shoqërie është: Import-eksport, tregëtim me shumicë e pakice i të gjitha mallrave industriale, elektrike e të aksesoreve të tyre, ushqimore, bujqesore, metale, duralumin, elektroshtepiake dhe materialeve të ndërtimore e të tjera. Blerje dhe tregëtim: Pajisje elektroshtepiake dhe higjieno-sanitare.
- 1.4 Shitesit **Endrit Zhapa**, është bashkë ortak i shoqërisë dhe zoteron 50 % të kapitalit të Shoqërisë, i shprehur në 1(një) kuote. Bazuar në vendimin e Asamblese së Përgjithshme me nr. 3Prot, datë 1/12/2024, të shoqërisë, dhe në përputhje me Ligjin "për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" Nr. 7850 datë 29.07.1994, Ligjin nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" dhe në përputhje dhe me statutin e shoqërisë "LumosTech-Solutions" shpk, palët kerkuan redaktimin e kontratës së shitjes së kuotes së kapitalit si më poshtë:

Baza Ligjore: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 705 dhe vijues të tij; Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"; Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Fq. 1



Neni 1. Objekti

Shitesi bie dakord të transferojë nepermjet shitjes ne total 100 % te pjeseve te kapitalit qe zoteron, e shprehur ne 1(nje) kuote, ne shoqerine "LumosTech-Solutions" shpk, tek bleresi dhe njekohesisht ortakut i shoqerise Z.Erold Balla, sipas cmimit te shitjes.

Neni 2. Çmimi i shitjes. Pagesa per çmimin e shitjes

2.1 Çmimi i shitjes së kuotës së kapitalit të shoqërisë që Blerësi i detyrohet Shitësit për blerjen e saj është në vlerë monetare 50,000(pesedhjetë mijë) leke.

2.2 Palët deklaronë se nga ana e Blerësit është likuiduar vlera monetare e sipërcituar prej 50,000(pesedhjetë mijë) leke , e cila përbën vlerën e plotë të pjesës së kuotës së shitësit, dhe palet nuk kanë asnjë pretendim në lidhje me pagesën.

2.3 Kuota e kapitalit, objekt i kësaj kontrate, është plotësisht e disponueshme, e transferueshme, dhe e lire nga çdo lloj pengu, hipoteke apo barre tjetër ligjore dhe pala shitese garanton palen blerese per sa me sipër. RBS e marrë nga Regjistri i Barres Siguruese do të jetë pjesë perberese e Kontrates.

2.4 Transferimi i pjesës së kapitalit ka efekt të menjehershëm. Bleresi është mbajtes i të drejtave dhe detyrimeve të kuotës së kapitalit të përfituar nepermjet këtij akti, menjehere pas nënshkrimit të aktit dhe rregjistrimit të tij pranë Qendes Kombetare të Rregjistrimit.

Neni 3. Konfigurimi pas shitjes së kuotës së kapitalit

3.1 Pas shitjes së kuotës së kapitalit, konfigurimi i kuotave të shoqërisë "LumosTech-Solutions" shpk, do të jetë:

Ortakut Erold Balla do të zotërojë 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë , me vlerë 100,000 (njëqind mijë) leke, duke u bërë në këtë mënyrë Ortakut i vetëm i shoqërisë "LumosTech-Solutions" shpk, me 2(dy) kuota me vlerë 50,000(pesedhjetë mijë) leke secila.

3.2. Endrit Zhapa humbet të drejtën mbi kuotën e kapitalit të shoqërisë "LumosTech-Solutions" shpk, si dhe çdo lloj të drejte tjetër të fituar nga Statuti i shoqërisë , si Administrator dhe Ortak njekohesisht.

Neni 4. Mosmarreveshjet

Mosmarreveshjet që lindin nga kjo kontratë do të zgjidhen me mirekuptim nga të dy palët, në rast të kundërt do të drejtohen gjykatës kompetente shqiptare.

Neni 5. Aneksat e Kontratës

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneksat të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me nr. 3, datë 1/12/2024, bashkëlidhur vërtetim nënshkrimi nr. _____ rep, Notere Adriana J. Solis;
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "LumosTech-Solutions" shpk , date 4/12/2024;
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barre Siguruese, Tiranë;
- Certifikatë familjare e palës Shitëse;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

Neni 6. Dispozitat Përfundimtare

6.1 Kontrata e Shitjes të kuotës së kapitalit u redaktua në 4 kopje origjinale, nga të cilat një kopje arkivohet në zyrën e Noterit, nga një kopje e marrin palët dhe një kopje dërgohet në QKB për



A2024051090017729299

regjistrim. Kontrata u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterës.

6.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

6.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALET KONTRAKTUESE**SHITES**

Endrit Zhapa

Endrit Zhapa

**NOTERI**

ADRIANA J. SOLIS

BLERES

Erold Balla

Erold Balla